



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1626
Dt 05.09.2019

Në zbatim të pikës 1, dhe 3 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 443/005 të datës 31.03.2017, nenit 70 paragrafit 1, të pikës 1.1, të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës dhe në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 86 të po këtij ligji dhe nenit 25 dhe 28 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës, marr këtë:

VENDIM

- I. Prof. dr. Rrahim Maksutit, profesor në Fakultetin e Gjeoshkencave, i ndërpritet marrëdhënia e punës sipas kontratës nr. prot. 1165 të datës 14.11.2014 dhe atë prej datës 05.09.2019.
- II. I përmenduri, duke filluar nga data 01.10.2019 do të kompensohet nga Universiteti i Mitrovicës vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, nëse njësia akademike ka nevojë, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit i përcaktuar me Rregulloren në fuqi për të ardhura personale të UMIB-it.
- III. Dekanati i Fakultetit të Gjeoshkencave, nëse ka nevojë, mund ta angazhojë të përmendurin për çdo semestër dhe zyrtarët përgjegjës të rektoratit do ta pajisin të përmendurin me kontratë për honorar, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, sipas Rregullores në fuqi për të ardhura personale të personelit akademik në UMIB.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues në vendimin nr. 443/005 të datës 31.03.2017, në 3 ka përcaktuar: 3. "Personeli akademik, i cili përcaktohet për marrëdhënie të rregullt pune me pagë primare në një institucion tjetër jashtë UMIB - it, nga Universiteti i Mitrovicës do të kompensohet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, nëse njësia akademike ka nevojë dhe jo më shumë se fondi i orëve të honorarit i përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UMIB – it."

I përmenduri përmes dekanit të njësisë akademike dhe në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues ka kërkuar ndërprerjen e marrëdhënies së rregullt të punës në UMIB dhe kalimin në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, sipas nevojës së njësisë akademike.

Prandaj, në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues, i cili bazuar në nenin 22, paragrafi 1.5 ka në kompetencë të definojë parimet mbi punësimin, delegimin, nivelizimin, promovimin, suspendimin, shkarkimin dhe përcaktimin e nivelit të pagave dhe kushteve të punës për personel, rektori i Universitetit të Mitrovicës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.